

VENDIM
Nr.24, datë 21.1.2000

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 393, DATË 3.9.1992, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 dhe 6, të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999, “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe të ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.393, datë 3.9.1992 bëhen këto ndryshime:

1. Në lidhjen I, “Renditja e funksioneve sipas klasifikimit”, në klasifikimin “A.12” shtohet emërtimi “Kryetari i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”.

2. Në lidhjen II-5, “Nivelet e pagës për punonjësit e ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore”, në pikën 3, të shtohet emërtimi “Kryetari i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”, dhe në lidhjen II-5/1, “Drejtori të Përgjithshme në varësi të ministrive”, në pikën 9, të hiqet emërtimi “Kryetari i Mbrojtjes së Mjedisit”.

3. Pagat e punonjësve të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit të jenë sipas lidhjes II-5, “Nivelet e pagës për punonjësit e ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore”, të vendimit nr.213, datë 28.3.1998, të Këshillit të Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta